



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 695/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17/10/2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-76378-06-26-2018, Loti 1, me objekt “*Implanti Koklear*”, me fond limit 47.625.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë”.

Ankimues: Operatori ekonomik “Evita” sh.p.k.
Autostrada Tiranë – Durrës, Km 8, rruga paralele, godinë private, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-76378-06-26-2018, Loti 1, me objekt “*Implanti Koklear*”, me fond limit 47.625.000 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 03.07.2018, operatori ekonomik ankimues “Evita” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kritereve të procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Pasi u njohem me dokumentacionin e tenderit.

Konkretisht specifikimet teknike Shtojca 10 gjykojme se nje pjese e tyre i referohen nje marke te caktuar dhe jane te paqarta duke mos lejuar mundesi ofertimi per marka te tjera qe kane te njejten performance ose dhe me larte saj.

Saktesojme: 1. Specifikimi - Numri i elektrodave stimuluese aktive reale në implant në njërën anë të elektrodës së futur në kokle. Numri i elektrodave stimuluese aktive ne implant duhet te jete 14-20. Ne studimet klinike te bera ne lidhje me implantet Kokleare rezulton se numri minimal i elektrodave stimulues qe mund te perdoren dhe qe ofrojne nje procesim te mire te zerit eshte 7. Ky specifikim me limitet e vendosura dhe me kriterin qe elektordat te jene vetem ne njeren ane kufizon ofertat e operatoreve ekonomik. Gjithashtu prodhues te ndryshem kane numer te ndryshem elektrodash aktive por mund te mos te perdoren te gjitha njekohesisht, pasi qe cilesia e procesimit te zerit nuk varet nga numri i madh i elektrodave te perdorura por nga thellesia qe elektroda futet ne kokle. Ne qofte se elektroda do te jete nga te dyja anet dhe me nje trashesi minimale sa me fleksibel per tu futur sa me thelle ne kokle atehere do te si guroje nje performance sa me te larte duke mbuluar keshtu edhe frekuencat e uleta. Kerkojme qe te hiqet kushti qe elektroda te jete vetem ne njeren ane gjithashtu dhe te behet ndryshimi ne: Numri i elektrodave stimuluese aktive ne implant duhet te jete 7-24.

2. Specifikimi - Sasia e nevojshme e fuqisë magnetike në BTE duhet te jete 6. Ky specifikim eshte i paqarte pasi prodhues te ndryshem perdorin shkalle/referenca te ndryshme te emertimeve te shkalles se fuqise se magnetit te gradueshme/ personalizueshme ne fuqi pozitive dhe negative ne varesi te nevojave specifike te secilit rast. Per me teper, ky specifikim nuk ka ndikim te drejteperdrejte ne performancen e implantit perkundrazi perdorimi i fuqise se madhe te magnetit ndikon negativisht tek pacienti duke komprimuar me tepri dhe shkaktuar problematika dha irritime te mundeshme lokale te lekures. Ky specifikim teknik eshte i paqarte dhe kufizon ne menyre te pajustificuar garen duke favorizuar ne menyre te njeaneshme prodhues specifik. Kerkojme sqarimin ku mbeshtetet referenca e kesaj pike dhe kerkojme heqjen e shkalles se fuqise magnetike 6 duke e lene te hapur.

3. Specifikimi- Numri i burimeve në implant është i barabartë me numrin e kanaleve aktuale reale. Kufizon ofertat per kete produkt pasi nuk justifikohet vendosja e numrit te njejte te kanaleve real me ate te burimeve ne implant ne lidhje me ndikimin e drejteperdrejte ne performance. Ne tregun aktual ofrohen produkte te cilat megjithese mbajne numrin e kanaleve aktuale reale kane nje numer me te madh burimesh pa ndikuar ne performance perkundrazi e permiresojne ate. Kerkojme qe specifikimi te ndryshohet ne: Numri i burimeve ne implant minimalisht te jete i barabarte me numrin e kanaleve aktuale reale

4. Specifikimi - Procesore i zërit me funksion regjistrues të mjedisit ku ka qënë pacienti. Ky specifikim te drejton drejt nje marke te vetme duke sjelle keshtu ngushtim te gares dhe duke mos lejuar mundesi ofertimi nga marka te tjera. Implanti koklear eshte nje audio procesor dhe duke gene nje i tille eshte e pamundur qe te gjurmohet. Kjo gje mund te arrihet vetem nese behet lidhja e implantit nepermjet bluetooth me nje smartphone i cili eshte i pajisur me GPS. Per te arritur te gjurmosh nje paisje duhet qe pajisa te jete patjeter e lidhur me internet.

Jo te gjithë pacientet kane mundesine per te patur nje smartphone dhe te lidhur ne internet gjate te gjithë kohes. Duke marre ne konsiderate arsyet e lartepmendura dhe ate cka eshte me kryesorja qe ky specifikim nuk ka ndikim ne performancen e implantit kerkojme heqjen e ketij specifikimi.

5. Specifikimi -Rezonancë Magnetike deri ne 1.5T pa patur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit. Mundësi e heqjes se përkohëshme te magnetit nga marresi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant. Duke marre parasysh qe trendi i teknologjise per rezonanca magnetike tashme ofrohet ne 3 T dhe duke marre ne konsiderate qe pacientet (femije dhe te rritur) do ta kene implantit koklear gjate te gjithë jetes sygjerojme qe fuqia e kerkuar e rezonances magnetike papatur nevojë te hiqet magneti nga trupi i imlantit te behet 3 T.[...]”

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes nëpërmjet shkresës nr.3327/4 prot., datë 06.07.2018, duke mos e pranuar atë, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Për sa i nërket pretendimit nr.1: Kërkesa për një numër të madh elektrodash aktive në implant shërben për dy qëllime: Së pari, meqë fibrat e nervit auditiv në kokle janë të rregulluara ne mënyrë torrotopike (kodimi i frekuencave varet nga vendi i stimulimit përgjatë gjatësisë së koklesë Tonotopic Theory) , më shumë elektroda sjellin rezolucion më të mirë të frekuencave.

Së dyti, nëse ka ndonjë regjion në kokle që nuk përgjigjet osë përgjigjet dobët, këto regjione evitohen gjatë programimit të pajisjes. Sqarojmë se, vendosja e elektrodave stimuluese në njërën anë të elektrodës së futur në kokle, bën që elektrodën të jenë me afërsi te modiolus. Kjo bën që qeliza e gougliant spiral të stimulojë me nivele më të ulëta elektrike, gjë që con në rritjen e jetës së baterisë. Për sa më sipër pretendimi i parë i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Për sa i nërket pretendimit nr.2: BTE duhet të ketë 6 (1-6) nivele magnetike në mënyrë që të përshatet për të gjithë personat të cilët kanë trashësi të ndryshme të lëkurës. Për sa më sipër pretendimi i dytë i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Për sa i përket pretendimit nr. 3: Është kërkuar numri i burimeve në implant të jetë i barabartë me numrin e kanaleve aktuale reale që duhet të ketë pajisja por kjo nuk përjashton pajisjet që kanë numër më të lartë kanalesh. Për sa më sipër pretendimi i tretë i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Për sa i përket pretendimit nr. 4: Kjo është një karakteristikë shumë e vlefshme në procesin e rehabilitimit, pasi i lejon programuesit ose rehabilituesit të futet në programin e pajisjes dhe të kontrollojë funksionimin e pajisjes, nëse pacienti ka qenë në mjedise të qeta apo zhurmuese, nëse është folur mjaftueshëm me të apo jo; si dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme për të patur sukses në procesin e rehabilitimit. Për sa më sipër pretendimi i katërt i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Përsa i përket pretendimit nr. 5: Rezonanca magnetike për arsye të ndryshme mund të kërkohet në personat e implantuar. Pajisja duhet të jetë e pajtueshme me MRI. Kemi specifikuar 1.5 Tesla sepse jep imazhe shumë cilësore dhe jep pak ose aspak artefakte në krahasim me 3T. Për sa më sipër pretendimi i pestë i Operatorit ekonomik nuk pranohet.[...]”

II.4. Në datën 13.07.2018 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si vijon:

“[...]Fillimisht na lejoni të parashtrojmë se në tregun ndërkombëtar të implanteve kokleare, 3 (tre) janë prodhuesit kryesorë të cilët janë të aprovuar nga USA FDA dhe të certifikuar (markuar) CE: MEDEL, Cochlear dhe Advanced Bionics, si dhe Nurotron, një prodhues i ri i sapo prezantuar në këtë fushë (https://en.ëikipedia.org/ëiki/Cochlear_implant#Manufacturers). Aktualisht Standartet ndërkombëtare kryesore të aplikueshme për këtë pajisje mjekësore janë: EN 45502-2-3:2010 Active implantable medical devices. Particular requirements for cochlear and auditory brainstem implant systems; ISO 14708-7:2013 Implants for surgery -Active implantable medical devices -Part 7: Particular requirements for cochlear implant systems; ANSI/AAMI CI86:2017 Cochlear Implant Systems Requirements for Safety, Functional Verification, Labeling, and Reliability Reporting. Ndërsa i vetmi standart kombëtar i aplikueshëm është: SSH EN 45502-2-3:2010 Pajisje mjekësore aktive të implantueshme Pjesa 2-3: Kërkesa të veçanta për sistemet e implantit për dëgjueshmërinë në kërmillin e veshit dhe në kolonën e trurit (që në thelb është versioni shqip i EN 45502-2-3-2010). Edhe pse ekzistojnë standartet e mësipërme specifikisht të dedikuara implantit koklear, AK, në Dokumentat e Tenderit, ka identifikuar si standarte për tu referuar dhe përmbushur nga konkurentët të mëposhtmet: ISO 9001:2008/ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë", per import eksport, tregetim të materialeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit; ISO 9001:2008/ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ose EN ISO 13485:2003/EN ISO 13485:2012/EN ISO 13485:2016 mbi "Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore", te prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit; BS ISO 5841-2:2014 mbi Implantet për kirurgji, te prodhuesit ne perputhje me objektin e prokurimi. Për më tepër, në mënyrë të vecantë në lidhje me Specifikimet Teknike, AK në shtojcën 10 "Specifikimet Teknike", ka përcaktuar që nga ofertuesit kërkohet: "Përputhje e plotë me standartet e fundit të ISO: ISO5841-2:2014", duke mos evidentuar asnjë nga standartet specifike të implantit koklear të listuara më sipër. Në nenin 23 pika 1, 2 dhe 3 dhe 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se : "1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit.

Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj. 5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emëri veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime". Gjithashtu në nenin 27 "Kontratat e Mallrave" pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara."

Vetë KPP, në një sërë vendimesh të vetat e ka qartësuar qëndrimin e vet në lidhje me metodologjinë që duhet ndjekur nga AK në hartimin e specifikimeve teknike. P.sh. në Vendimin nr.256/2017, KPP shprehet se: "Në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se kriteret dhe/ose specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e aktit nënligjor në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Gjithashtu duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale.

Gjithashtu edhe metoda e tretë e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit".

Në ankesën tonë, konkretisht në pikën (2) të kundërshtimeve tona ne i kemi kërkuar AK:

"Kerkojme sqarimin ku mbeshtetet referenca e kesaj pike", duke e referuar këtë kërkesë për sqarim edhe në nenin 43 të LPP të cilësuar në bazën ligjore të ankesës, por nga ana e AK nuk na është dhënë një përgjigje për këtë çështje të ngritur nga ana jonë, pra për metodologjinë e ndjekur nga AK në zbatim të nenit 23 të LPP. Pikërisht kjo paqartësi e AK në lidhje me metodologjinë e ndjekur për përcaktimin e specifikimeve teknike, ka shpënë në hartimin e specifikimeve teknike të tilla që lehtësisht do të krijojnë panoramën e mëposhtme për sa i përket përmbushjes së tyre nga prodhuesit e vetëm që ekzistojnë në tregun ndërkombëtar për implantet kokleare:

Nr	Specifikim teknik	AB	Cochlear	MED-EL	Nurotron
1.	Trashësia e pjesës së brëndhsme të sistemit të implantit koklear duhet të jetë 4 mm – 6 mm.	PO	PO	PO	JO
2.	Trashësia e pjesës bazale të elektrodës duhet të jetë deri në 8 mm	PO	PO	PO	PO
3.	Matje direkte e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti pa paisje ose elektroda të jashtme shtesë	PO	PO	PO	PO
4.	Numri i elektrodave stimuluese active (reale) në implant në njërën anë të elektrodës së future në kokle duhet të jetë 14 - 20	PO	PO	JO	PO
5.	Fuqia e impaktit të shtresës së implantit (pjesët e implantit) Fuqia e shtresës së implantit duhet të jetë 2.5-5J	PO	PO	PO	JO
6.	Mundësia për të dhënë një processor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kycit të	JO	PO	PO	JO

	<i>nofullës ose syzeve)</i>				
7.	<i>Sasia e nevojshme e fuqisë magnetike në BTE duhet të jetë 6</i>	???	<i>PO</i>	<i>PO</i>	???
8.	<i>Mundësia për të dhënë një processor zëri kundra ujit (ëaterproof)</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>JO</i>
9.	<i>Sistemi i implantit koklear i pajisur me telekomandë për kontrollin ne distancë të procesorit të zërit</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>JO</i>
10.	<i>Numri i mikrofonëve në procesorin e zërit duhet te jete 2 - 3</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>
11.	<i>Numri i burimeve në implant është i barabartë me numrin e kanaleve aktuale reale</i>	<i>PO</i>	<i>JO</i>	<i>PO</i>	<i>JO</i>
12.	<i>Procesori i zërit me program që ndryshon automatikisht, pa patur nevojë të rregullohet me butonat e pjesës së jashtme. Po kerkohet ndryshim automatik</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>
13.	<i>Procesore i zërit me funksion regjistrues të mjedisit, ku ka qënë pacienti</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>JO</i>
14.	<i>Implant me këllëf titaniumi për stimulatorin e receiverit</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>JO</i>
15.	<i>Zgjedhje opsionale e një elektrode me vendosje perimodiolare. Jo nuk duhet te perfshihet</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO/JO</i>	<i>JO</i>
16.	<i>Rezonancë Magnetike deri ne 1.5T pa patur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>
17.	<i>Mundësi e heqjes së përkohëshme te magnetit nga marresi/ stimulatori për të bërë Rezonancë</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>

	<i>Magnetike të kokës me implant</i>				
18.	<i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>
19.	<i>Mundesit e dhenies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual</i>	<i>PO</i>	<i>JO(???)</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>
20.	<i>Garanci implanti të paktën 10 vjet. Garancia për procesorin e zërit është 3 vjet</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>	<i>PO</i>

Nga tabloja e mësipërme krahasuese, e cila bazohet në specifikimet teknike të produktit të secilit prej prodhuesve të identifikuar dhe të certifikuar FDA dhe CE në tregjet ndërkombëtare, rezulton qartë, se në rastin më të mirë, specifikimet sic janë lejojnë që të vazhdojë garën edhe pse në mënyrë të dyshimtë vetëm njëri nga prodhuesit, ndërsa në rastin më të keq, gara do duhet të mbetet pa asnjë konkurent dhe të dështojë. Në këtë mënyrë, rrezikohet që të mos realizohen pikërisht objektivi dhe parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të LPP, duke u cënuar ose barazia dhe transparenca, ose ekonomiciteti dhe efektiviteti në përdorimin e fondeve publike. [...]

[...] Për sa i përket pretendimit nr.1: Kërkesa për një numër të madh elektrodash aktive në implant shërben për dy qëllime: Së pari, meqë fibrat e nervit auditiv në kokle janë të rregulluara në mënyrë tonotopike (kodimi i frekuencave varet nga vendi i stimulimit përgjatë gjatësisë së koklesë Tonotopic Theory), më shumë elektroda sjellin rezolucion më të mirë të frekuencave.

Së dyti, nëse ka ndonjë regjion në kokle që nuk përgjigjet osë përgjigjet dobët, këto regjione evitohen gjatë programimit të pajisjes. Sqarojmë se, vendosja e elektrodave stimuluese në njërin anë të elektrodës së futur në kokle, bën që elektrodën të jenë me afërsi të modiolus. Kjo bën që qelizat e gougliant spiral të stimulojë me nivele më të ulëta elektrike, gjë që con në rritjen e jetës së baterisë. Për sa më sipër pretendimi i parë i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë se: Së pari, për sa i përket të ashtuquajturës Tonotopic Theory: Fibrat nervore në koklea janë të organizuara në mënyrë tonotopike.

Është e vërtetë që prodhuesit e tjerë të ndryshëm nga MED-EL, ofrojnë një numër më të lartë elektrodash, po gjatësia e futjes së tyre është më e vogël, duke mos stimuluar fibrat nervore në mënyrë tonotopike, por duke gjenruar një ngacmim jonatyral në lartësi. Gjithashtu edhe një numër më i ulët elektrodash, mjaft që të jenë maksimalisht fleksibël, kanë mundësi të mbërrijnë majën e koklesë dhe të stimulojnë në mënyrë tonotopike. (Shiko Shtojca 4 Greenood.pdf page 3 fig 1.) Pra, tonotopia, në këtë rast është një argument në favour të disajnit me më pak elektroda por të gjata dhe fleksibël, si në rastin e zgjidhjes së ofruar nga MED-EL, që në konkluzion rezulton e ndryshme nga pikëpamja e dizajnit, por realizon njësoj funksionin/performancën.

Nga ana tjetër, një hapësirë më e madhe mes elektrodave kur janë më pak të tilla, eliminon, ndërhyrjen ndërmjet kanaleve. Së dyti, për sa i përket pretendimit të AK, se nëse ka regjione në kokle që nuk përgjigjen, ose përgjigjen dobët, këto evitohen gjatë programimit të pajisjes, sjellim këtu një studim shkencor (Shtojca 5 Fishman.pdf fq. 13): "Asnjë ndryshim në performancën mesatare, nuk u vu re me rritjen e numrit të elektrodave nga 7 në 20"; dhe (Shtojca 6 Naito.pdf fq. 4): "... numri i elektrodave ka pak rëndësi, për sa kohë janë të paktën 10 të tilla. Kjo tregon se praktika aktuale e përdorimit të 20 elektrodave mund të mos jetë e nevojshme.". P.sh. implant i MED-EL ka elektroda rezervë, të cilat, nëse prishet njera, mund ta zëvendësojnë, duke stimuluar të njejtën zonë. Së treti, për sa i përket pretendimit të AK se vendosja e elektrodave stimuluese në njerën anë të elektrodës së future në kokle, bën që elektroda të jetë më në afërsi të modiulusit etj., sqarojmë se elektrodën perimodulare kanë një risk të madh në drejtim të përthyerjes dhe dëmtimit në këtë mënyrë të strukturës së koklesë. (Shtojca 7 Èanna.pdf): "... Ne rekomandojmë përdorimin e elektrodave LË (lateral ëall), të futura me metodën ERË ose RË..."

Për sa i përket pretendimit nr.2: BTE duhet të ketë 6 (1-6) nivele magnetike në mënyrë që të përshtatet për të gjithë personat të cilët kanë trashësi të ndryshme të lëkurës. Për sa më sipër pretendimi i dytë i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë sa vijon: Ky specifikim referon drejtpërdrejtë në skedën teknike të produktit të prodhuesit Cochlear Nucleus 6 (Shiko Shtojca 8.pdf fq.18: 6 different magnet strengths). Gjithashtu AK, është e paqartë dhe kontradiktore me vetveten në përgjigjen që jep, pasi në specifikimin sic është shkruar në Shtojcën 10 të Dokumentave të Tenderit, përcakton se sasia e nevojshme fuqisë magnetike në BTE duhet të jetë 6, ndërsa në përgjigje shprehet që: "BTE duhet të ketë 6 (1-6) nivele magnetike". Kjo nuk është serioze.

Përsa i përket pretendimit nr. 3: Është kërkuar numri i burimeve në implant të jetë i barabartë me numrin e kanaleve aktuale reale që duhet të ketë pajisja por kjo nuk përjashton pajisjet që kanë numër më të lartë kanalesh. Për sa më sipër pretendimi i tretë i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë sa vijon: Në këtë qëndrim të vetin AK është kontradiktore me vetveten, pasi nga një anë në arsyetimin e vet pranon pretendimin tonë, por nga ana tjetër në konkluzion shprehet se kërkesa jonë nuk pranohet!!!

Përsa i përket pretendimit nr. 4: Kjo është një karakteristikë shumë e vlefshme në procesin e rehabilitimit, pasi i lejon programuesit ose rehabilituesit të futet në programin e paisjes dhe të kontrollojë funksionimin e pajisjes, nëse pacienti ka qenë në mjedise të qeta apo zhurmuese, nëse

është folur mjaftueshëm me të apo jo; si dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme për të patur sukses në procesin e rehabilitimit. Për sa më sipër pretendimi i katërt i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Përsa i përket pretendimit nr. 5: Rezonanca magnetike për arsye të ndryshme mund të kërkohet në personat e implantuar. Pajisja duhet të jetë e pajtueshme me MRI. Kemi specifikuar 1.5 Tesla sepse jep imazhe shumë cilësore dhe jep pak ose aspak artefakte në krahasim me 3T. Për sa më sipër pretendimi i pestë i Operatorit ekonomik nuk pranohet.

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë sa vijon: Kjo është qartësisht e pasaktë: 3T jep rezolucion më të qartë! Për më tepër në kushtet e avancimit teknologjik dhe kur Implanti Koklear rri në trupin e pacientit për më shumë se 30 vjet, pacienti nuk mund të vendosë nëse spitalet pas një periudhe kaq të gjatë do të kenë akoma në përdorim skanera MRI me 1.5 T, kur në ditët e sotme skanerat 3T janë zëri i fundit. Gjithashtu, AK bie në kontradiktë me vetveten, pasi nga një anë për specifikimin në 4 më sipër, përkrah avancimin teknologjik, në këtë rast e injoron. [...]”

II.5. Në datën 25.07.2018, nëpërmjet shkresës me nr.3468/3 prot., datë 24.07.2018, me objekt “Informacion për procedurën e prokurimit me nr. REF- 76378-06-26-2018 me objekt Loti I Implanti Koklear, me fond limit 47.625.000 (dyzet e shtatë milion e gjashtëqind e njëzet e pesë” lekë pa TVSH”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit si vijon: “[...] Kërkojme që të hiqet kushti që elektroda të jete vetem në njerën anë gjithashtu dhe të behet ndryshimi në: Numri i elektrodave stimuluese aktive në implant duhet të jete 7-24 [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: “Implanti Koklear - Numri i elektrodave stimuluese aktive (reale) në implant në një të elektrodës së futur në kokle. Numri i elektrodave stimuluese aktive në implant duhet të jete 14 – 20”.

III.1.2. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se :

“1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

b) *kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

c) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

III.1.3. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPPdhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.1.4. Në nenin 30 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “[...]Procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurimet.”

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specififikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specififikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specififikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu, edhe metoda e tretë, e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.1.6. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë kriter argumenton “[...]Për sa i përket pretendimit nr.1: Kërkesa për një numër të madh elektrodash aktive në implant shërben për dy qëllime: Së pari, meqë fibrat e nervit auditiv në kokle janë të rregulluara në mënyrë torrotopike (kodimi i frekuencave varet nga vendi i stimulimit përgjatë gjatësisë së koklesë Tonotopic Theory) , më shumë elektroda sjellin rezolucion më të mirë të frekuencave.

Së dyti, nëse ka ndonjë regjion në kokle që nuk përgjigjet osë përgjigjet dobët, këto regjione evitohen gjatë programimit të pajisjes. Sqarojmë se, vendosja e elektrodave stimuluese në njërën anë të elektrodës së futur në kokle, bën që elektrodën të jenë me afërsi te modiolus. Kjo bën që qeliza e gougliant spiral të stimulojë me nivele më të ulëta elektrike, gjë që con në rritjen e jetës së baterisë”.

III.1.7. Në përcaktimin e këtyre dy specifikimeve teknike të mësipërme: “Numri i elektrodave stimuluese aktive reale në implant në njërën anë të elektrodës së futur në kokle. Numri i elektrodave stimuluese aktive ne implant duhet te jete 14-20”, në këtë mënyrë formulimi, operatori ekonomik ankimes pretendon se të çojnë në drejtim të vetëm të një prodhuesi, duke shmangur konkurrencën dhe pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar. Operatori ekonomik ankimes në lidhje me këtë kriter pretendon “[...]Së pari, për sa i përket të ashtuquajturës Tonotopic Theory: Fibrat nervore në koklea janë të organizuara në mënyrë tonotopike. Është e vërtetë që prodhuesit e tjerë të ndryshëm nga MED-EL, ofrojnë një numër më të lartë elektrodash, po gjatësia e futjes së tyre është më e vogël, duke mos stimuluar fibrat nervore në mënyrë tonotopike, por duke gjeneruar një ngacim jonatyral në lartësi. Gjithashtu edhe një numër më i ulët elektrodash, mjaft që të jenë maksimalisht fleksibël, kanë mundësi të mbërrijnë majën e koklesë dhe të stimulojnë në mënyrë tonotopike. (Shiko Shtojca 4 Greenood.pdf page 3 fig 1.) Pra, tonotopia, në këtë rast është një argument në favour të disajnit me më pak elektroda por të gjata dhe fleksibël, si në rastin e zgjidhjes së ofruar nga MED-EL, që në konkluzion rezulton e ndryshme nga pikëpamja e dizajnit, por realizon njësoj funksionin/performancën.

Nga ana tjetër, një hapësirë më e madhe mes elektrodave kur janë më pak të tilla, eliminon, ndërhyrjen ndërmjet kanaleve. Së dyti, për sa i përket pretendimit të AK, se nëse ka regjione në kokle që nuk përgjigjen, ose përgjigjen dobët, këto evitohen gjatë programimit të pajisjes, sjellim këtu një studim shkencor (Shtojca 5 Fishman.pdf fq. 13): “Asnjë ndryshim në performancën mesatare, nuk u vu re me rritjen e numrit të elektrodave nga 7 në 20”; dhe (Shtojca 6 Naito.pdf fq. 4): “... numri i elektrodave ka pak rëndësi, për sa kohë janë të paktën 10 të tilla. Kjo tregon se praktika aktuale e përdorimit të 20 elektrodave mund të mos jetë e nevojshme.”. P.sh. implant i MED-EL ka elektroda rezervë, të cilat, nëse prishet njera, mund ta zëvendësojnë, duke stimuluar të njejtën zonë. Së treti, për sa i përket pretendimit të AK se vendosja e elektrodave stimuluese në njërën anë të elektrodës së future në kokle, bën që elektroda të jetë më në afërsi të modiolusit etj., sqarojmë se elektrodën perimodulare kanë një risk të madh në drejtim të përthyerjes dhe dëmtimit në këtë mënyrë të strukturës së koklesë. (Shtojca 7 Wanna.pdf): “... Ne rekomandojmë përdorimin e elektrodave LW (lateral wall), të futura me metodën ERW ose RW...”

III.1.8. Sa më sipër, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknike kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Konkretisht, në këtë rast, referuar edhe pretendimeve të ankimesit, gjykojmë se përcaktimi i elektrodave vetëm në njërën anë të elektrodës është një tregues që ndikon thjesht në paraqitjen e produktit (dizenjimin) dhe jo në performancën e tij, ndaj KPP gjykon se, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë kufizime të tilla në përcaktimin e specifikimeve teknike përse kohë që performanca e produktit arrihet me secilën formë të dizenjimit të vendosjes së elektrodave, mjaft që modelet të kenë konfirmimin CE ose miratimin FDA (pra realizohet performancë pavarësisht dizenjimit, domethënë performanca nuk varet nga dizenjimi), në kushtet kur edhe nga ana e autoritetit kontraktor në kthimin e përgjigjes dhe në informacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk jep informacion në lidhje me performancën e produktit, por i referohet thjesht jetës së baterisë së produktit, e cila (bacteria) nuk është e lidhur me sa më sipër.

Sa më sipër, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike në lidhje me paraqitjen e elektrodave në njërën anë, duke e hequr këtë kriter si diskriminues dhe që nuk ndikon në performancën e produktit.

III.1.9. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes përse i përket përcaktimit të parametrave minimum e maksimum të elektrodave (14-20), autoriteti kontraktor, sqaron se, kërkesa për një numër të madh elektrodash aktive në implant shërben për dy qëllime: Së pari, meqë fibrat e nervit auditiv në kokle janë të rregulluara në mënyrë torrotopike (kodimi i frekuencave varet nga vendi i stimulimit përgjatë gjatësisë së koklesë Tonotopic Theory) , më shumë elektroda sjellin rezolucion më të mirë të frekuencave.

III.1.10. Nisur nga fakti që numri i elektrodave është një element i rëndësishëm që ndikon në performancën e produktit, KPP gjykon se, përcaktimi i një numri të tillë do të ishte i domosdoshëm. Nga ana tjetër në lidhje me përcaktimin e këtij numri, në kushtet kur në studime të ndryshme shkencore mjekësore, referuar hulumtimeve në internet, përcaktohet se, nën numrin 4 të elektrodave ndihet ndikimi në performancë, ndërsa në numrin e elektrodave me mbi 7 të tilla nuk vihet re një ndikim i tillë, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të mësipërm përse i përket numrit minimal të elektrodave duke e përcaktuar atë në përputhje me qëllimin se përse e kërkon këtë produkt me qëllim edhe hapjen e garës për një pjesëmarrje e konkurrencë të gjerë me rezultat përfitimim e një produkti me performancë. Në lidhje me përcaktimin e numrit të elektrodave në kufirin maksimal (20) të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor, referuar pretendimeve të ankimesit, si edhe hulumtimeve të shumta, gjykojmë se performanca është e lidhur me funksionin e pajisjes, dhe si e tillë përcaktimi i një kufiri maksimal do të ndikonte në performancë, përse kohë që një pajisje me një numër elektrodash edhe më të lartë se 20 e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, do të realizonte dhe përmbushte më së miri interesat e autoritetit kontraktor. Përcaktimi i një numri të tillë maksimal është kufizues dhe pengon pjesëmarrjen duke shmangur një operator ekonomik me një pajisje me një numër më të lartë elektrodash në kufirin maksimal e si rrjedhim edhe me performancë më të mirë.

Sa më sipër analizuar, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të mësipërm duke modifikuar numrin e elektrodave në kufirin minimal (duke e ulur atë) dhe numrin e elektrodave në kufirin maksimal duke e hequr e lënë të hapur me qëllim përfitimin e një produkti me performancë sa më të lartë.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit si vijon: “[...] *Specifikimi - Sasia e nevojshme e fuqisë magnetike në BTE duhet të jete 6. Ky specifikim eshte i paqarte pasi prodhues te ndryshem perdorin shkalle/referenca te ndryshme te emertimeve te shkalles se fuqise se magnetit te gradueshme/personalizueshme ne fuqi pozitive dhe negative ne varesi te nevojave specifike te secilit rast. Per me teper, ky specifikim nuk ka ndikim te drejteperdrejte ne performancen e implantit perkundrazi perdorimi i fuqise se madhe te magnetit ndikon negativisht tek pacienti duke komprimuar me tepri dhe shkaktuar problematika dha irritime te mundeshme lokale te lekures. Ky specifikim teknik eshte i paqarte dhe kufizon ne menyre te pajustificuar garen duke favorizuar ne menyre te njeaneshme prodhues specifik. Kerkojme sqarimin ku mbeshtetet referenca e kesaj pike dhe kerkojme heqjen e shkalles se fuqise magnetike 6 duke e lene te hapur [...]*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: *“Implanti Koklear - Sasia e nevojshme e fuqisë magnetike në BTE duhet të jete 6”*.

III.2.2. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se :

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit.

Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifitimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.2.3. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.2.4. Sa më sipër analizuar, KPP gjykon se në hartimin e specifitimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specififikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Në hartimin e specifitimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specififikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifitimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifitimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.2.5. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë kriter argumenton “[...]BTE duhet të ketë 6 (1-6) nivele magnetike në mënyrë që të përshtatet për të gjithë personat të cilët kanë trashësi të ndryshme të lëkurës. Për sa më sipër pretendimi i dytë i Operatorit ekonomik nuk pranohet”.

III.2.6. Operatori ekonomik ankimes pretendon: “Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë sa vijon: Ky specifikim referon drejtpërdrejtë në skedën teknike të produktit të prodhuesit Cochlear Nucleus 6 (Shiko Shtojca 8.pdf fq.18: 6 different magnet strengths). Gjithashtu AK, është e paqartë dhe kontradiktore me vetveten në përgjigjen që jep, pasi në specifikimin sic është shkruar në Shtojcën 10 të Dokumentave të Tenderit, përcakton se sasia e

nevojshme fuqisë magnetike në BTE duhet të jetë 6, ndërsa në përgjigje shprehet që: “BTE duhet të ketë 6 (1-6) nivele magnetike”. Kjo nuk është serioze”.

III.2.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, sqaron se, parametri 6, në fakt është në kufijtë nga 1-6 nivele magnetike, duke sqaruar përcaktimin e bërë në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, vetë autoriteti kontraktor ka pranuar që BTE duhet të ketë 1-6 nivele magnetike duke e lënë të hapur këtë parametër me kufij minimalë e maksimalë, si edhe duke përmbushur njëkohësisht pretendimin e operatorit ekonomik ankimues.

Nga ana tjetër, referuar edhe sqarimit të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, pasi një përcaktim i tillë është diskriminues dhe përjashtues nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Vetë autoriteti kontraktor e ka cilësuar që BTE duhet të ketë 1-6 nivele magnetike. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar operatorit ekonomik në lidhje me nivelet magnetike në nivelet 1-6, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se autoriteti kontraktor, duhet të bëjë përcaktimet e sakta, në mënyrë që të mos krijojë konfuzion dhe paqartësi, si tek operatorët ekonomikë gjatë hartimit të ofertës, ashtu edhe tek komisioni i vlerësimit të ofertave më pas, gjatë procesit të shqyrtimit të ofertave. Konstatohet se, autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë sqarim në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se ku është bazuar në përcaktimin e këtij kriteri.

Nga ana tjetër, është po vetë autoriteti kontraktor që në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues sqaron se ky parametër do të jetë në nivelet 1-6.

Si rrjedhim, sa më sipër analizuar, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës, duke bërë publikimin në shtojcën përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike, duke reflektuar në sistemin e prokurimeve përcaktimin e dhënë që “BTE do të jetë 1-6 nivele” vendimmarrjen e tij.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit si vijon: “[...] Numri i burimeve në implant është i barabartë me numrin e kanaleve aktuale reale. Kufizon ofertat për këtë produkt pasi nuk justifikohet vendosja e numrit të njejtë të kanaleve real me atë të burimeve në implant në lidhje me ndikimin e drejteperdrejte në performance. Në tregun aktual ofrohen produkte të cilat megjithatë mbajnë

numrin e kanaleve aktuale reale kane nje numer me te madh burimesh pa ndikuar ne performance perkundrazi e permiresojne ate. Kerkojme qe specifikimi te ndryshohet ne:

Numri i burimeve ne implant minimalisht te jete i barabarte me numrin e kanaleve aktuale reale [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: “*Implanti Koklear - Numri i burimeve në implant është i barabartë me numrin e kanaleve aktuale reale*”.

III.3.2. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se :

“1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

b) *kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

c) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

III.3.3. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPPdhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.3.4. Sa më sipër analizuar, KPP gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në

mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.3.5. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë kriter argumenton “*[...]Përsa i përket pretendimit nr. 3: Është kërkuar numri i burimeve në implant të jetë i barabartë me numrin e kanaleve aktuale reale që duhet të ketë pajisja por kjo nuk përjashton pajisjet që kanë numër më të lartë kanalesh. Për sa më sipër pretendimi i tretë i Operatorit ekonomik nuk pranohet*”.

III.3.6. Operatori ekonomik ankimues pretendon: “*Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë sa vijon: Në këtë qëndrim të vetin AK është kontradiktore me vetveten, pasi nga një anë në arsyetimin e vet pranohet pretendimin tonë, por nga ana tjetër në konkluzion shprehet se kërkesa jonë nuk pranohet!!!*”.

III.3.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues sqaron se (citojmë): *kjo nuk përjashton pajisjet që kanë numër më të lartë kanalesh*, duke sqaruar dhe pranuar argumentin dhe pretendimin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, duke sqaruar përcaktimin e bërë në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, vetë autoriteti kontraktor ka pranuar që nuk është kufizuese dhe e detyrueshme që numri i burimeve në implant të jetë vetëm i barabartë me numrin e kanaleve aktuale reale, duke përcaktuar dhe lënë të hapur që nuk do të përjashtohen pajisjet që kanë numër më të lartë kanalesh, e cila në këtë mënyrë përcaktimi përmbush njëherazi edhe pretendimin e operatorit ekonomik ankimues.

Nga ana tjetër, referuar edhe sqarimit të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, pasi, një përcaktim i tillë është diskriminues dhe përjashtues nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk

duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Vetë autoriteti kontraktor e ka cilësuar që nuk do të jetë përjashtuese paraqitja e pajisjeve më një numër më të lartë kanalesh, pra duke përcaktuar në këtë mënyrë që do të lejohen pajisje me një numër të kanaleve të barabartë ose më të lartë se numri i kanaleve aktuale reale.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, autoriteti kontraktor, duhet të bëjë përcaktimet e sakta, në mënyrë që të mos krijojë konfuzion dhe paqartësi, si tek operatorët ekonomikë gjatë hartimit të ofertës, ashtu edhe tek komisioni i vlerësimit të ofertave më pas, gjatë procesit të shqyrtimit të ofertave.

Nga ana tjetër, është po vetë autoriteti kontraktor që në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues sqaron se ky përcaktim, pra numri i burimeve në implant do të jetë i barabartë me numrin e kanaleve, por, duke mos përjashtuar pajisjet që kanë numër më të lartë kanalesh, duke e modifikuar në të njëjtën kohë këtë kriter si edhe duke pranuar pretendimin e operatorit ekonomik ankimues.

Si rrjedhim, sa më sipër analizuar, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës, duke bërë publikimin në shtojcën përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike, duke reflektuar në sistemin e prokurimeve përcaktimin e dhënë që “numri i burimeve në implant të jetë i barabartë ose më i lartë se numri i kanaleve aktuale reale”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit si vijon: “[...]. *Specifikimi - Procesore i zërit me funksion regjistruar të mjedisit ku ka qënë pacienti. Ky specifikim te drejton drejt nje marke te vetme duke sjelle keshtu ngushtim te gares dhe duke mos lejuar mundesi ofertimi nga marka te tjera. Implanti koklear eshte nje audio procesor dhe duke qene nje i tille eshte e pamundur qe te gjurmohet. Kjo gje mund te arrihet vetem nese behet lidhja e implantit nepermjet bluetooth me nje smartphone i cili eshte i pajisur me GPS. Per te arritur te gjurmosh nje paisje duhet qe pajia te jete patjeter e lidhur me internet. Jo te gjithë pacientet kane mundesine per te patur nje smartphone dhe te lidhur ne internet gjate te gjithë kohes. Duke marre ne konsiderate arsyet e lartepemendura dhe ate cka eshte me kryesorja qe ky specifikim nuk ka ndikim ne performancen e implantit kerkojme heqjen e ketij specifikimi [...]*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: “*Implanti Koklear - Procesore i zërit me funksion regjistruar të mjedisit, ku ka qënë pacienti*”.

III.4.2. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar*

sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.4.3. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

III.4.4. Sa më sipër analizuar, KPP gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë

operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.4.5. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë kriter argumenton “[...]Përsa i përket pretendimit nr. 4: Kjo është një karakteristikë shumë e vlefshme në procesin e rehabilitimit, pasi i lejon programuesit ose rehabilituesit të futet në programin e paisjes dhe të kontrollojë funksionimin e pajisjes, nëse pacienti ka qenë në mjedise të qeta apo zhurmuese, nëse është folur mjaftueshëm me të apo jo; si dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme për të patur sukses në procesin e rehabilitimit. Për sa më sipër pretendimi i katërt i Operatorit ekonomik nuk pranohet”.

III.4.6. Operatori ekonomik ankimues pretendon: “Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë sa vijon: Në këtë qëndrim të vetin AK është kontradiktore me vetveten, pasi nga një anë në arsyetimin e vet pranon pretendimin tonë, por nga ana tjetër në konkluzion shprehet se kërkesa jonë nuk pranohet!!!”.

III.4.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, sqaron se, kjo është një karakteristikë e vlefshme, duke bërë të mundur që programuesi apo rehabilituesi të futet në programin e paisjes dhe të kontrollojë funksionimin e pajisjes, duke pranuar faktin se, në lidhje me këtë karakteristikë specifike është e domosdoshme që pajisja të jetë e lidhur domosdoshmërisht me internet, fakt ky i pakundërshtuar nga autoriteti kontraktor. Në lidhje me këtë specifikim, edhe nga verifikimet dhe hulumtimet në internet, rezulton se vetëm një prodhues e gëzon këtë cilësi të pajisjes, pra faktin e lidhjes me internet me qëllim gjurmimin dhe kontrollin e funksionimit të pajisjes. Nga ana tjetër, në kushtet kur është e nevojshme lidhja me internet, sqarojmë se, autoriteti kontraktor në përcaktimin e specifikimeve teknike duhet të mbajë parasysh që specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor, duhet të ketë parasysh përcaktimet e bëra në legjislacionin për prokurimin publik në hartimin e kriterëve për kualifikim të cilat, bazuar në nenin 46 të ligjit për prokurimin publik, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm. Në rastin konkret, referuar edhe përgjigjes së autoritetit kontraktor, konstatohet se, që pajisja të kryejë funksionet që autoriteti kontraktor citon në kthimin e përgjigjes, duhet që patjetër pajisja të jetë e lidhur me internet, por nga ana tjetër, autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh edhe faktin se pajisja do të përdoret nga një pjesë e gjerë e popullatës, e cila, në varësi të moshës apo edhe mundësive financiare nuk janë në gjendje të kenë në posedim një mjet të teknologjisë së fundit smartphone (pretendim ky i ngritur nga ankimuesi edhe pranë autoritetit kontraktor e për të cilin nga ana e këtij të fundit nuk janë dhënë fakte e argumenta apo kundërshtimet përkatëse).

Sa më sipër, në përcaktimin e këtij parametri specifik, autoriteti kontraktor, përveç sa u tha më lart, duhet të ketë parasysh gjatë hartimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike, edhe faktin që specifikimet teknike ti shërbejnë qëllimit të pajisjes së kërkuar, si edhe të kenë ndikim në rastin konkret në performancën e produktit.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër arsyetuar, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimet përkatëse të dokumentave të tenderit, duke e hequr specifikimin e sipërcituar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit si vijon: “[...]Specifikimi -Rezonancë Magnetike deri ne 1.5T pa patur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit. Mundësi e heqjes se përkohëshme te magnetit nga marresi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant. Duke marre parasysh qe trendi i teknologjise per rezonanca magnetike tashme ofrohet ne 3 T dhe duke marre ne konsiderate qe pacientet (femije dhe te rritur) do ta kene implantit koklear gjate te gjithë jetes sygjerojme qe fuqia e kerkuar e rezonances magnetike papatur nevojë te hiqet magneti nga trupi i imlantit te behet 3 T [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: “Implanti Koklear - Rezonancë Magnetike deri ne 1.5T pa patur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit”.

III.5.2. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se :

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

b) *kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

c) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

III.5.3. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.5.4. Sa më sipër analizuar, KPP gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrin të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.5.5. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë kriter argumenton “[...] *Rezonanca magnetike për arsye të ndryshme mund të kërkohet në personat e implantuar. Pajisja duhet të jetë e pajtueshme me MRI. Kemi specifikuar 1.5 Tesla sepse jep imazhe shumë cilësore dhe jep pak ose aspak artefakte në krahasim me 3T. Për sa më sipër pretendimi i pestë i Operatorit ekonomik nuk pranohet*”.

III.5.6. Operatori ekonomik ankimues pretendon: “Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë sa vijon: Kjo është qartësisht e pasaktë: 3T jep rezolucion më të qartë! Për më tepër në kushtet e avancimit teknologjik dhe kur Implanti Koklear rri në trupin e pacientit për më shumë se 30 vjet, pacienti nuk mund të vendosë nëse spitalet pas një periudhe kaq të gjatë do të kenë akoma në përdorim skanera MRI me 1.5 T, kur në ditët e sotme skanerat 3T janë zëri i fundit.

Gjithashtu, AK bie në kontradiktë me vetveten, pasi nga një anë për specifikimin në 4 më sipër, përkrah avancimin teknologjik, në këtë rast e injoron [...]”.

III.5.7. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor, si edhe dokumentacionit dhe informacionit të këtij të fundit drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, konstatojmë se autoriteti kontraktor nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me arsyetimet apo argumentimet e përcaktimit të kriterëve të mësipërme, pasi në njërin rast i referohet një teknologjie sa më të avancuar (pretendimi i katërti i operatorit ekonomik ankimues) dhe në një rast tjetër nuk i referohet teknologjisë më të avancuar (pretendimi i pestë i operatorit ekonomik ankimues). Në lidhje me këtë specifikim, edhe nga verifikimet dhe hulumtimet në internet, rezulton se ka disa prodhues që e disponojnë këtë parametër në pajisjet e tyre, e si rrjedhim, duke mbajtur të njëjtin në qëndrim si edhe në pretendimin e arsyetuar në pikën III.4. të këtij vendimi, KPP gjykon se, pavarësisht se kemi të bëjmë me një teknologji më të avancuar në rastin e parametrin 3T, përse kohë që në treg janë disa prodhues që e disponojnë një pajisje të tillë me këtë parametër, ky përcaktim nuk është përjashtues apo diskriminues. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ky përcaktim i bërë në dokumentat e tenderit, referuar studimeve dhe hulumtimeve të bëra nga ana e autoritetit kontraktor, sipas të cilit (citojmë) “Kemi specifikuar 1.5 Tesla sepse jep imazhe shumë cilësore dhe jep pak ose aspak artefakte në krahasim me 3T”, është një argumentim mbi bazën e të cilit ky parametër ndikon në performancën e pajisjes.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriterë që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriterë të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriterë apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjisllacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër arsyetuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë specifikim teknik nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-76378-06-26-2018, Loti 1, me objekt “Implanti Koklear”, me fond limit 47.625.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Evita” sh.p.k.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1257 Protokolli

Datë 13.07.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha